

# Statistikat afatshkurtra


## Prodhuesit e të mirave - Tremujori IV 2019

**Tiranë, më 13 Mars 2020:** Treguesit tremujorë mbi prodhuesit e të mirave, të cilat përfshijnë aktivitetet ekonomike: Industri (Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, Gaz, Avull; Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve; Ndërtim, në tremujorin e katërt 2019, paraqiten si më poshtë:

### Industri:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 2,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 5,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 2,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Industri (%)




### Energji elektrike, Gaz, Avull

Indekset e treguesve në aktivitetin Energji elektrike, Gaz, Avull, në tremujorin e katërt 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 8,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 10,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 2,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 2,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Energji elektrike, Gaz, Avull (%)




### Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve

Indekset e treguesve në aktivitetin Furnizimi me ujë dhe Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve, në tremujorin e katërt 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 1,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 8,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 3,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rënie 0,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Furnizimin me ujë, Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve (%)**




**Ndërtim**

Indekset e treguesve në aktivitetin Ndërtim, në tremujorin e katërt 2019, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 9,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rënie 7,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 0,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 0,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto, Ndërtim (%)**



**Tab. 1 Indeksi i shitjeve neto në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.IV 2019 (2015=100)	IV.19 / IV.18 (%)	Tr.IV 2019 (2015=100)	IV.19 / III.19 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	<b>114,0</b>	<b>2,8</b>	<b>110,3</b>	<b>2,4</b>
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	85,0	3,6	84,0	11,1
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	129,6	2,5	124,3	-0,5
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	113,6	-8,4	117,4	-7,0
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	99,1	-1,8	103,5	8,4
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	<b>141,5</b>	<b>-9,1</b>	<b>121,0</b>	<b>-6,4</b>
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	129,9	-1,1	124,7	2,9
		Energji	94,4	-2,8	95,6	-0,5
		Mallra kapitale	131,0	-10,5	121,0	-1,0
		Mallra të qëndrueshme konsumi	128,9	13,5	109,0	-9,2
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	125,3	7,1	125,6	2,6

**Tab. 2 Indeksi i prodhimit në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.IV 2019 (2015=100)	IV.19 / IV.18 (%)	Tr.IV 2019 (2015=100)	IV.19 / III.19 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	<b>105,7</b>	<b>5,4</b>	<b>103,4</b>	<b>3,6</b>
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	91,1	9,6	92,0	20,8
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	121,0	3,9	117,1	-0,6
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	66,4	10,9	78,0	19,1
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	97,8	8,3	106,2	6,8
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	<b>144,5</b>	<b>-7,9</b>	<b>124,2</b>	<b>-8,9</b>
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	118,1	5,9	113,1	6,3
		Energji	69,4	21,6	81,2	23,5
		Mallra kapitale	152,4	2,1	141,6	-1,9
		Mallra të qëndrueshme konsumi	128,1	18,1	112,4	-6,8
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	119,1	2,3	119,2	-0,8

**Tab. 3 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Numri i të të punësuarve		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja		Tr.IV 2019 (2015=100)	IV.19 / IV.18 (%)	Tr.IV 2019 (2015=100)	IV.19 / IV.18 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	114,0	1,1	126,8	2,6
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	92,5	1,6	120,5	1,9
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	117,3	1,1	130,7	2,9
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	114,0	2,3	160,1	2,4
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	116,2	-3,4	132,3	-0,8
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	114,0	0,2	128,6	0,4

# Metodologjia

## Informacion

Në vazhdim të përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave afatshkurtra me statistikat evropiane, INSTAT publikon Statistikat Afatshkurtra –Të mira si më poshtë :

- Indekset duke filluar nga tremujori i parë 2019, do të llogariten me vit bazë 2015=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore e Ndërmarrjeve për vitin 2017, realizuar nga INSTAT.

## Informacion mbi vrojtimin

**Qëllimi** - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

### Në prodhuesit e të mirave:

**Fusha e mbulimit** - Bazuar në aktivitetin kryesor, në anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike, gaz, avull (35)
- Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (36-39)
- Ndërtim (41, 42, 43)

**Modeli** - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

**Mbledhja e informacionit** - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2015=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

**Ndryshimi vjetor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

*Ndryshimi tremujor në përqindje* - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

**Përkufizimet e treguesve kryesorë**

*Shitjet neto* - *Shitjet neto* përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar.

*Indeksi i shitjeve neto* - Objektivi i indeksit të *shitjeve neto* është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

*Numri i të punësuarve me pagesë* - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përfshirë të vetëpunësuarit me pagesë).

*Paga dhe trajtime* - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

*Indeksi i fondit të pagave* - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

**Grupimet Industriale Kryesore** janë një rigrupim i aktiviteteve Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese dhe Energji të detajuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), si më poshtë:

Grupimet Industriale Kryesore	NVE Rev.2
Mallra të ndërmjetme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 07-09 Nxjerja e mineraleve natyrore; Nxjerja e mineraleve të tjera nga minierat; Aktivitete mbështetëse minerare</li> <li>• 13000 Përpunimi i tekstileve</li> <li>• 16000 Prodhimi i drurit dhe materialeve prej druri, përveç mobiljeve</li> <li>• 17000 Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre</li> <li>• 20-21 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike; Përpunimi i produkteve farmaceutike</li> <li>• 22000 Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës</li> <li>• 23000 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike</li> <li>• 24000 Metalurgjia</li> <li>• 255XX Farkëtimi, stampimi, petëzimi dhe trafilizimi i metaleve</li> <li>• 27000 Prodhimi i pajisjeve elektrike</li> </ul>
Energji	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 05-06 Nxjerja e qymyrit dhe linjiteve; Nxjerja e naftës bruto dhe gazit natyror</li> <li>• 19000 Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës</li> <li>• 35000 Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar</li> </ul>
Mallra kapitale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 251XX Prodhimi i produkteve metalike strukturore</li> <li>• 262XX Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike</li> <li>• 28000 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 33000 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve</li> </ul>
Mallra të qëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 264XX Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët</li> <li>• 31000 Prodhimi i mobiljeve</li> <li>• 32XXX Industri të tjera p.k.t</li> </ul>
Mallra të paqëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 10000 Përpunimi i produkteve ushqimore</li> <li>• 11-12 Prodhimi i pijeve; Prodhimi i produkteve të duhanit</li> <li>• 14000 Konfeksionimi i veshjeve</li> <li>• 15000 Prodhimi i lëkures dhe produkteve prej lëkure</li> <li>• 18000 Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara</li> <li>• 32YYY Industri të tjera p.k.t</li> </ul>

### Përshtatja sezonale

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të prodhimit të të mirave materiale u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.1.0. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2006 - Tremujori IV 2019. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave afatshkurtra. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.